



UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE
PROGRAMI: DIZAJN SOFTUERI

PROGRAMI MËSIMOR - SYLLABUS							
Niveli i studimeve		Bachelor	Programi	DS	Viti akademik	2018/2019	
LËNDA		INTERAKSIONI NJERI-KOMPJUTER					
Viti	1	Statusi i lëndës	Zgjedhore	Kodi		ECTS kredi	6
Semestri	II						
Javët mësimore		15		Orët mësimore	60	Ligjërata	Ushtrime
						2	2
Metodologjia e mësimit		Ligjërata, ushtrime në kabinet të TI, shfrytëzimi i metodës multimediale në prezantime, detyra seminarike, konsulta, testim.					
Konsultime		Dy orë në javë					
Mësimdhënësi		Dr.sc. Mevlan Qafleshi		e-mail	mevlan_loni@yahoo.com		
				Mob. Tel.			
Asistenti		M.sc. Betim Maloku		e-mail	betim.maloku@uni-prizren.com		
				Tel.			
Qëllimi studimor i lëndës				Përfitimet e studentit			
<ul style="list-style-type: none"> • Interaksioni njeri kompjuter (INjK) është një lëndë interdisiplinore që integron teorinë dhe metodologjinë nga shkencat kompjuterike, psikologjia kognitive, dizajni, dhe shumë fusha tjera. • Ky kurs u jep studentëve njohuri themelore për për dizajnuar interfejse për përdoruesit bazuar në mundësitë e teknologjisë kompjuterike dhe nevojat/kërkesat e faktorëve njerëzor. • Kursi do të sigurojë një ekuilibër të njohurive teorike dhe praktike, duke u dhënë studentëve përvojë që nuk ofrohet nga kurse tjera në fushën e shkencave kompjuterike. 				Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • kuptojë bazat e shkathtësive dhe kufizimeve të njeriut në ndërveprimin me kompjuterët. • kuptojë teorinë themelore, mjetet dhe teknikat në INjK. • kuptojë aspektet fundamentale të dizajnit dhe vlerësimit të interfejseve. • praktikojë një sërë metodash të thjeshta për vlerësimin e cilësisë së interfejsit të përdoruesit. • aplikojë teknika të duhura në INjK për të dizajnuar sisteme që janë të përdorshme nga njerëzit. 			
Metodologjia për realizimin e temave mësimore:							
Ligjërata, ushtrime, detyra/angazhime praktike, konsultime, punime seminarike, videoprezantime.							
Kushtet për realizimin e temës mësimore:							
-Literatura e përshtatur me kërkesat e moduleve; -Tabela për shënimin e koncepteve themelore për të paraqitur lidhjen algoritmike të tyre në lëndën e INjK; -PC dhe projektori për paraqitjen dhe demonstrimin e moduleve dhe problemeve kryesisht atyre më të avancuara; -Ushtrime reale dhe simulative për dizajnimin dhe parashikimin e sistemeve për zgjidhjen e problemeve dhe interfejseve të nevojshme; -Ushtrime laboratorike për të konkretizuar mënyrat e dizajnit, funksionimit dhe zbatimet e qasjeve të propozuara si zgjidhje specifike e problemeve teorike dhe atyre praktike në përgjithësi.							

Mënyra e vlerësimit të studentit (në %)		Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
I Kollokviume-Projekt-Vijueshmëri (100%)	Vlerësimi i parë (Kollokviumi I)	30	(50-60)% - nota 6
	Vlerësimi i dytë (Kollokviumi II)	30	(61-70)% - nota 7
	Projekt/Punim seminari	30	(71-80)% - nota 8
	Vijueshmëria në ushtrime dhe ligjërata	10	(81-90)% - nota 9
II Provim-Projekt-Vijueshmëri (100%)	Provim final	60	(91-100)% - nota 10
	Projekt/Punim seminari	30	
	Vijueshmëria në ushtrime dhe ligjërata	10	

Obligimet e studentit:

Ligjërata	Ushtrime
Studenti duhet të jetë i rregullt në ndjekjen e ligjëratave, të jetë aktiv, i vëmendshëm dhe interaktiv gjatë elaborimit të temave mësimore. Duhet të shfrytëzojë literaturën bazë dhe shtesë për nxënien e njohurive themelore të këtij moduli mësimor.	-Duhet të ndjekë në mënyrë obligative ushtrimet. -Të jetë i përgatitur paraprakisht për ushtrimin/ushtrimet që janë të caktuara në orar. -Punimet seminarike duhet t'i përgatisë dhe t'i mbrojë me sukses dhe të jetë në gjendje t'iu përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave nga debati për punimin e caktuar.

Ngarkesa e studentit për lëndën

Aktiviteti	Orë/javë	Ditë/javë	Gjithsej orë:
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime (kabinet të TI)	2	15	30
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	2	15	30
Punë praktike	2	2	4
Projekte, prezantime..etj.	2	3	6
Koha e studimit vetanak	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	4	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	4	3	12
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		Ngarkesa totale:	150

Java	Ligjërata	Ushtrime		
	Tema	Orët	Tema	Orët
1	Hyrje- Interaksioni Njeri-Kompjuter (NNJK).	2	Prezantimi i temave për punime seminarike. Grupet punuese.	2
2	Njeriu.	2	Identifikimi i aftësive të ndryshme fiziologjike, psikologjike dhe motorike të njerëzve gjatë ndërveprimit me kompjuter.	2
3	Kompjuteri.	2	Mënyrat të ndryshme të futjes/marrjes së të dhënave në/nga kompjuteri.	2
4	Interaksioni.	2	Modelet e përshtatjes së ndërveprimit njeri-kompjuter për raste të veçanta.	2
5	Paradigma në INjK.	2	Paradigma në INjK.	2
6	Interfejsi grafik për përdoruesin - GUI.	2	Shembuj të GUI në gjuhë programuese.	2
7	Vlerësimi intermediar-Kollokviumi I.	2	Vlerësimi intermediar-Kollokviumi I.	2
8	Realiteti Virtual.	2	Modele të zbatimit të realitetit virtual.	2

9	Bazat e dizajnit të sistemeve të ndërveprimit.	2	Skenare të dizajnit të ndërveprimit për qëllime/detyra të ndryshme dhe pengesa.	2
10	INjK në proceset e softuerit.	2	Roli i INjK në dizajnimin e softuereve.	2
11	Rregullat e dizajnit.	2	Parime, standarde dhe udhëzime për dizajne.	2
12	Teknikat e vlerësimit.	2	Mënyrat/teknikat e vlerësimit të dizajneve.	2
13	Dizajni universal.	2	Shembuj të ndërveprimit të shqisave me kompjuter.	2
14	Mbrojtja dhe vlerësimi i punimeve seminarike. Përgatitja për kollokvium/provim.	2	Mbrojtja dhe vlerësimi i punimeve seminarike. Përgatitja për kollokvium/provim.	2
15	Vlerësim: Kollokviumi i II (dytë).	2	Vlerësim: Kollokviumi i II (dytë).	2

LITERATURA

Literatura bazë:

Dr.sc. Mevlan Qafleshi: Ligjërata të autorizuara (Prezantime)-Ndërveprimi Njeri-Kompjuter, Prizren, 2018.

Literatura shtesë:

Alan Dix, Janet Finlay, Gregory d. Abowd, Russell Beale. Human- Computer Interaction. Pearson Education Limited, 2004. UK.

VËREJTJE

Koha/data e vlerësimit me test (kollokviumet) caktohet nga mësimdhënësi në varësi të planifikimit të përmbledhjes së temave të caktuara për testim. Vlerësimi final (provimi) në fund të semestrit caktohet nga zyrtari(ët) kompetent i njësisë akademike.

Materiali bazë për ligjërata dhe ushtrime sigurohet nga mësimdhënësi i lëndës. Studentët inkurajohen të shfrytëzojnë edhe literaturë dhe materiale tjera dhe t'i paraqesin si tema për diskutim.

Studentët mund të propozojnë tema dhe ide që janë të lidhura me procesin e ngritjes dhe avancimit shkencor në këtë fushë studimi.

Vërejtje për studentin:

- Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe i ushtrimeve në veçanti,
- Bashkëpunim i bazuar në rregullat universitare,
- Respektimi i orarit të mësimit, konsultimeve dhe testimeve.
- Respektim i Kodit Etik dhe Statutit të Universitetit,
- Studentët gjatë ligjëratave nuk duhet të pengojnë zhvillimin normal të mësimit.